



Datë: 25.12.2025
Numër Protokoll: 8120/2025

A.nr.1400/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1400/2025, të datës 17.07.2025, të parashtruar nga ankuesi H.M, kundër organit të punësimit Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1400/2025, e datës 17.07.2025, e parashtruar nga ankuesi H.M.
- II. Mbetet** në fuqi Vendimi me Nr. 186/2025, i datës 25.06.2025, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për sistemimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

A r s y e t i m

Ankuesi H.M (*me tej referuar vetëm ankuesi*), me datë 17.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.186/2025, të datës 25.06.2025, me numër protokoll Sh.02 Nr.16788, të datës 04.07.2025, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për sistemimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Sektori të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për shkak të shkeljes së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4810/2025 të datës 17.07.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin me Nr. 186/2025, të datës 25.06.2025, me numër protokoll Sh.02 Nr.16788 dhe datë 04.07.2025, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 22.07.2025; Përgjigjen në ankesë

e datës 12.08.2028; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit i datës 09.03.2020; Konkursin e brendshëm (avancim) i datës 14.02.2020; Autorizimin për publikim e konkursit i datës 12.02.2020; Përshkrimin e detyrave të punës për Përgjegjës i Sektorit të Shëndetësisë datës 06.02.2020; Akt Emërimit e datës 03.07.2017; Vendimin A.nr.513/2025 të datës 20.05.2025 të KPMSHCK-së; Vendimi me Nr. 185/2025, të datës 25.06.2025, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, Kontratën e Marrëdhënies së Punës të datës 14.02.2019 të F.R.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses nuk është e bazuar, *sepse*:

Vlerësimi i gjendjes së fakteve

-Ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 03.07.2017, ka qenë i emëruar në pozitën Zyrtar për Personel, në Komunën e Kamenicës, ndërsa, pas konkursit të brendshëm (avancim) të datës 14.02.2020, i njëjti sipas akt emërimit Sh.02 Nr.7130 të datës 09.03.2020, është emëruar në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Kamenicës.

-Sipas vendimit të kontestuar rrjedhë së ankuesi ishte caktuar në pozitën Udhëheqës i Departamenti të Administratës në QKMF Kamenicë, pozitë të cilën sipas aktit të emërimit e kishte ushtruar nëpunësja civile F.R, e cila sipas Vendimit me numër protokolli 26636 të datës 28.08.2019, për shkak të marrjes se funksionit publik si këshilltare e Kuvendit Komunal të Kamenicës, kishte pezulluar këtë pozitë të punës.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimet A.nr. 994/21 të datës 04.09.2024 dhe A.nr.513/2025 të datës 20.05.2025, kishte aprovuar ankesën e ankueses znj. F.R, duke e detyruar Kryetarin e Komunës së Kamenicës që të njëjtën ta kthej në pozitën që ka mbajtur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, apo në një pozitë ekuivalente brenda këtij institucioni, me status të nëpunësit të shërbimit publik.

-Në zbatim të vendimit A.nr.513/2025 të datës 20.05.2025, Kryetari i Komunës së Kamenicës, më datë 25.06.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 185/2025 me të cilin znj. F.R e ka sistemuar në pozitën Udhëheqëse e Administratës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Kamenicës.

-Tutje, Kryetari i Komunës së Kamenicës, më datë 25.06.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 186/2025, dhe me numër protokolli SH 02 Nr.16788 datë 04.07.2025, me të cilin ankuesin nga pozita e Udhëheqësit të Administratës në QKMF Kamenicë e ka sistemuar sipas akt emërimit të datës 09.03.2020, në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se me vendimin e kontestuar i është ndërruar statusi nga nëpunës i shërbimit publik në nëpunës të shërbimit civil në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kërkon që të shfuqizohet vendimi dhe të kthehet në vendin e punës në QKMF në Kamenicë.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të prova materiale të çështjes konstaton së nuk gjejnë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të ankuesit mbi arsyet së ankuesi pas procedurës së avancimit, më datë 09.03.2020 ishte emëruar Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Kamenicës, ndërsa, në atë kohë zyrtarja F.R ka qenë e emëruar më kontratë pune si Udhëheqëse e Departamentit të Administratës, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Kamenicës sipas kontratës së marrëdhënies së punës të datës 14.02.2019 dhe se e njëjta kishte pezulluar marrëdhënien e punës sipas Vendimit me numër protokolli 26636 të datës 28.08.2019, për shkak të marrjes se funksionit publik si këshilltare e Kuvendit Komunal të Kamenicës.

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore thekson faktin së emërimi i ankuesit në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Kamenicës është bërë në kohën ku ishte në fuqi Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe rrjedhimisht sipas këtij cilit ligj të punësuarit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, duke përjashtuar stafin profesional të sistemit shëndetësor janë trajtuar zyrtarë më status të nëpunësit civil, dhe status të njëjtë ka pas edhe ankuesi si Udhëheqës i Sektorit Shëndetësisë në kuadër të Komunës së Kamenicës. Ndërsa, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më datë 20.07.2020 përkatësisht me nenin 2 paragrafi 4 të këtij ligji është përcaktuar se të gjithë të punësuar si pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e shëndetësisë(nga pozita e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike) kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, dhe së një rregullim të tillë ligjor e parasheh edhe Ligji nr.08L-1 Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si ligj i aplikueshëm nga data 26.09.2023.

Andaj, duke qenë së zyrtarja publike F.R pas përfundimit të funksionit publik si këshilltare e Kuvendit Komunal të Kamenicës, ka parashtrua kërkesë për kthim ne vendim e saj të punës, e drejtë kjo e përcaktuar me nenin 89 paragrafi 1, nënpika 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli përmes vendimmarrjes së tij më Vendimin A.nr. 994/21 të datës 04.09.2024 dhe A.nr.513/2025 të datës 20.05.2025, ka detyruar Kryetarin e Kryetarin e Komunës së Kamenicës që të njëjtën ta kthej në pozitën që ka mbajtur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, apo në një pozitë ekuivalente brenda këtij institucioni, me status të nëpunësit të shërbimit publikë, dhe në zbatim të Vendimit të KPMSHCK-së 513/2025, zyrtarja F.R është sistemuar në pozitën Udhëheqëse e Departamentit të Administratës në QKMF Kamenicë, pozitë të cilën ankuesi e ka ushtruar gjatë kohës sa zyrtarja F.R ka pas të pezulluar marrëdhënien e punës, kështu që, mbi këto rrethana vendimi i kontestuar nuk përben akt të paligjshëm sepse ankuesi është kthyer në pozitën për të cilën është emëruar pas procedurës së rekrutimit dhe se i njëjtë nuk ka pësuar ndonjë dëm në kuptim të kategorisë se pozitës.

Kolegji i Këshillit nisur nga konstatimet si më sipër vjen në përfundimin se pretendimi ankimor se ankuesit i është ndryshuar statusi nga nëpunës i shërbimit publik në nëpunës të shërbimit civil, është i paqëndrueshëm, sepse marrëdhënie e punës sipas akt emërimit të fundit Sh.02 Nr.7130 të datës 09.03.2020, si Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale është marrëdhënia e punës në shërbim civil, rrjedhimisht, ankuesi ka pas pozitën e nëpunësit civil, andaj, edhe sistemi i ankuesit sipas Vendimit Nr. 186/2025, të datës 25.06.2025 ,është bërë në pozitë të njëjtë sipas aktit të emërimit me numër SH 02 Nr. 7130 të datës 09.03.2020, kështu që, vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk është përfshirë në shkelje procedurale dhe materiale

dhe kështu nuk janë plotësuar kushtet për paligjshmëri të këtij vendimi të përcaktuara sipas nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1400/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit H.M;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.